HAGIOTOPONYMS OF THE KOLONJA REGION AS LINGUISTIC MONUMENTS

HAGIOTOPONIME TË TREVËS SË KOLONJËS SI MONUMENTE GJUHËSORE[1]

Lonora HYSOLLI

Department of Language and Literature, Faculty of Education and Philology
"Fan S.Noli" University Korçë, Albania
E-mail address : lhysolli@unkorce.edu.al

Abstrakt

Ky punim merr në shqyrtim hagiotoponimet (toponimet me burim nga emrat e shenjtorëve dhe objekteve të kultit) në trevën e Kolonjës dhe Leskovikut, duke i trajtuar ato si monumente të gjalla gjuhësore dhe arkiva të kujtesës kolektive. Përmes një qasjeje historiko-krahasuese dhe analizës etimologjike, studimi bazohet në burime dokumentare të shekullit XX, përfshirë hartografimin e institucioneve fetare të vitit 1924 dhe regjistrat kishtarë të vitit 1946 (siç janë të dhënat mbi kishat antike të Prodanit, Rehovës, Barmashit, etj.). Në qendër të kërkimit është analiza e evolucionit fonetik dhe përshtatjes morfologjike të këtyre emërtimeve në gojën e popullatës vendase (p.sh. trajtat e sinkopuara apo përthithjet e nyjave topofonike). Hulumtimi nxjerr në pah se si kisha të dokumentuara që nga shekulli XVII (si ajo e Shën Ilisë në Prodan, datuar rreth vitit 1646, apo e Shën Mitrit në Skorovot) kanë shërbyer si bërthama onomastike që kanë gjeneruar mikrotoponimi të qëndrueshme rreth tyre. Përmes kësaj analize linguistike, punimi synon të dëshmojë vjetërsinë e banimit të krahinës, shtresëzimet krono-linguistike dhe mënyrën se si gjuha shqipe ka asimiluar dhe ruajtur elementet sakrale përgjatë shekujve, duke ofruar një kontribut të ri në fushën e onomastikës shqiptare.

Keywords: hagiotoponime, gjuhësi historike, Kolonjë, Leskovik, onomastikë sakrale, evolucion fonetik.

Abstract

This paper examines the hagiotoponyms (toponyms derived from the names of saints and places of worship) in the region of Kolonja and Leskovik, treating them as living linguistic monuments and archives of collective memory. Through a historical-comparative approach and etymological analysis, the study is grounded in 20th-century documentary sources, including the mapping of religious institutions from 1924 and ecclesiastical registers from 1946 (such as data regarding the ancient churches of Prodan, Rehova, Barmash, etc.). The core of the research focuses on analyzing the phonetic evolution and morphological adaptation of these designations within the local speech vernacular (e.g., syncopated forms or the absorption of topofonetic articles). The research highlights how churches documented since the 17th century (such as Saint Elijah in Prodan, dated circa 1646, or Saint Demetrius in Skorovot) served as onomastic nuclei that generated stable surrounding microtoponyms. Through this linguistic analysis, the paper aims to demonstrate the antiquity of the region's settlement, the chrono-linguistic stratifications, and the mechanisms by which the Albanian language assimilated and preserved sacral elements across centuries, offering a novel contribution to Albanian onomastics.

Keywords: hagiotoponyms, historical linguistics, Kolonja, Leskovik, sacral onomastics, phonetic evolution.

1. Hyrje

Onomastika, si disiplinë që merret me studimin e emrave të përveçëm, përfshin fusha të ndryshme të kërkimit, ndër të cilat toponimia, antroponimia dhe degëzime më të specializuara që lidhen me lloje të veçanta emrash (Kostallari, 1965; Shkurtaj, 2015). Literatura bashkëkohore e trajton onomastikën si një fushë të gjerë, në të cilën studimi i emrave të

[1] Ky punim u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (NASRI, Shqip: AKKSHI). Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorit, dhe opinionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e AKKSHI- së.

https://doi.org/10.62792/ut.icfra.y2026.i2.pp161

përveçëm ndërthuret me gramatikën, semantikën, diskursin, sociolinguistikën, historinë, dialektologjinë dhe kontaktet gjuhësore (Hough, 2016).
Kësisoj, toponimia e një treve përbën një nga arkivat më të qëndrueshëm dhe më besnikë të historisë së saj kulturore e gjuhësore. Ndër shtresat e ndryshme toponimike, një vend të rëndësishëm shkencor zënë edhe hagiotoponimet (nga greqishtja *hagios – "i shenjtë"* dhe *topos – "vend"*), të cilat emërtojnë vendet sipas institucioneve të kultit apo emrave të shenjtorëve.
E shtrirë në një pozicion gjeografik strategjik në juglindje të Shqipërisë, një zonë kufitare me historik të pasur kontakti gjuhësor (shqiptar-sllav-grek-vllah), treva e Kolonjës dhe e Leskovikut paraqet një terren mjaft interesant për studimin e onomastikës sakrale Kjo krahinë ka shërbyer historikisht si një udhëkryq i rëndësishëm kulturor, ku simbioza midis traditave të krishtera të hershme dhe zhvillimeve të mëvonshme islame (veçanërisht atyre bektashie) ka lënë gjurmë të pashlyeshme në gjuhë. Emri i një kishe, manastiri, xhamie, teqeje ose vendi të shenjtë mund të shërbejë si pikë orientimi për një territor të caktuar dhe në përdorimin e përditshëm të komunitetit, të marrë funksionin e një shenje hapësinore (Hough, 2016).
Ky proces është veçanërisht i rëndësishëm për mikrotoponiminë. Ndryshe nga toponimet që identifikojnë njësi më të mëdha territoriale, mikrotoponimet lidhen me hapësira me shtrirje të kufizuar: një arë, kodër, shpat, pyll, burim, rrugicë, livadh, krua, përrua apo edhe vendbanim të vogël. Shpesh, këto emërtime ruhen kryesisht në komunikimin e banorëve dhe mund të mos kenë një përdorim të qëndrueshëm në dokumentacionin administrativ. Pikërisht për këtë arsye, mikrotoponimia përbën një burim të rëndësishëm për të evidentuar kujtesën lokale të hapësirës dhe mënyrën se si një komunitet e organizon dhe e dallon territorin përmes emrave (Shkurtaj, 2001). Emrat e vendeve të lidhura me objektet e kultit mund të shihen si një shtresë e veçantë e materialit onomastik të rajonit: ata dëshmojnë ndërveprimin midis gjuhës, territorit, komunitetit dhe trashëgimisë kulturore, duke krijuar një urë të drejtpërdrejtë ndërmjet studimit onomastik dhe realitetit historiko-gjeografik të trevës së Kolonjës (Shkurtaj, 1996; Hough, 2016). Një analizë e tyre do të mbështetet në burime dokumentare, harta, regjistra lokalë, materiale arkivore, dëshmi gojore dhe të dhëna nga terreni, duke bërë të mundur krahasimin e emërtimit historik me përdorimin bashkëkohor. Për një studim të emërtimeve të objekteve të kultit në rajonin e Kolonjës, kjo qasje është veçanërisht e dobishme, sepse lejon që toponimi dhe mikrotoponimi të trajtohen jo thjesht si lista emrash, por si sisteme gjuhësore që ruajnë informacion mbi organizimin, perceptimin dhe kujtesën e hapësirës lokale (Hough, 2016).
Emërtimet e objekteve të kultit mund të analizohen në dy drejtime të ndërlidhura. Në drejtimin e parë, hapësira përcakton objektin, kur një kishë, xhami ose teqe identifikohet përmes vendit ku është ndërtuar. Në drejtimin e dytë, objekti ndikon në emërtimin e hapësirës, duke bërë që emri i tij të përdoret për të përcaktuar edhe territorin përreth. Në këtë rast kemi një zgjerim të funksionit referues të emrit: ai nuk tregon më vetëm ndërtesën ose vendin e kultit, por edhe një zonë të njohur nga komuniteti nëpërmjet lidhjes së saj me atë objekt (Dizdari, 2005).
Në këtë studim, një vend të veçantë zë *Hagionimia,* pra studimi i emrave të shenjtorëve dhe emërtimeve të lidhura me figurat e shenjta. Kjo fushë lidhet drejtpërdrejt me emërtimin e kishave dhe të vendeve të kultit, pasi një numër i konsiderueshëm i objekteve të kultit marrin emrin e një shenjtori ose të një ngjarjeje të rëndësishme të traditës liturgjike (Elsie, 2000). *Bugaeva*, në studimin e saj mbi *Hagiotoponyms*, e lidh toponiminë e shenjtë me shprehjen e botëkuptimit fetar dhe dallon kategori të tilla si: *hagionym* [hagionimi], *hagiotoponym* [hagiotoponimi] dhe *hagioanthroponym* [hagioantroponimi]. Pra, në onomastikën fetare, *hagionimia* ndërthuret me *hagiotoponiminë* dhe *hagioantroponiminë,* duke krijuar një fushë të veçantë të studimit të emërtimeve të lidhura me kultin, hapësirën e shenjtë dhe traditën antroponimike (Hough, 2016).
Termi *hagionimi* përdoret vetëm për emërtimet e shenjtorëve dhe figurave të shenjta. Ai duhet dalluar nga antroponimia e zakonshme: një emër, si *Gjergj,* mund të jetë antroponim i një

personi të gjallë, ndërsa *Shën Gjergj* është hagionim. Kur hagionimi kalon në emërtimin e një kishe, ai bëhet pjesë e *eklezionimisë* që është *fusha e studimit onomastik, e cila merret me emërtimet e kishave dhe objekteve të tjera kishtare dhe islame, me strukturën, motivimin, prejardhjen dhe funksionin e tyre.,* (Hough, 2016).
Në këtë punim termi përdoret për emërtimet që kanë si bërthamë një objekt kulti: Kisha e Shën Kollit, Kisha e Shën Mëhillit etj. (Elsie, 2000). Eklezionimia e Kolonjës mund të studiohet përmes një tipologjie të emërtimeve, duke dalluar, ndër të tjera, emrat e bazuar në:

- emrin e një shenjtori;
- emrin e dy ose më shumë shenjtorëve;
- një ngjarje ose festë të ciklit liturgjik;
- një emërtim të lidhur me ikonën;

Një model i dobishëm analitik për këtë marrëdhënie është: *Shenjtori → Objekti i kultit → Hapësira → Mikrotoponimi* (Hough, 2016).
Për shembull: *Shën Ilia → Shëndëllia → Lagjja e Shëndëllisë → Kodra e Shëndëllisë.*
Ky model nuk është mekanik në çdo rast, por ndihmon për të përshkruar procesin e emërtimit. Emri i shenjtorit mund të paraprijë objektin; objekti mund të bëhet pikë reference; pika e referencës mund të emërtojë terrenin përreth. (Elsie, 2000)
Studimi ynë merr shkas nga dy dokumente me vlerë të jashtëzakonshme monumentale dhe arkivore: 1. Harta e vitit 1924 mbi "Institucionet Fetare dhe Arsimore" të nënprefekturave të Kolonjës dhe Leskovikut (ruajtur në muzeun e Ersekës) dhe një dokument me shkrim dore , shkëputur nga regjistri zyrtar klerikal i vitit 1946 dërguar kryesisë së Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në Tiranë nga zëvendësi i atij rrethi, Atë Stavro At. Naumi. Këto dy dokumente dëshmojnë ekzistencën empirike të dhjetëra pikave sakrale, të cilat, përtej funksionit fetar, kanë kryer rolin e bërthamave gjuhësore rreth të cilave është thurur mikrotoponimia e fshatrave dhe zonave përreth. Pavarësisht se datimi i këtyre burimeve i takon fillimshekullit XX, ato tregojnë trashëgimi të konsoliduar.
Përmes metodës historiko-krahasuese, qëllimi kryesor i punimit tonë është që të analizojë këto hagiotoponime e eklezionime jo thjesht si tregues gjeografikë, por si monumente gjuhësore që mbartin me vete zhvillimet fonetike të dialektit toskë, ruajtjen e trajtave popullore arkaike dhe mënyrën se si sistemi i shqipes i ka integruar dhe asimiluar emërtimet sakrale të sferës bizantine dhe asaj perëndimore.

2. Kuadri metodologjik dhe burimet dokumentare

Për realizimin e këtij punimi është ndjekur një metodologji e kombinuar sinkronike dhe diakronike, me fokus të veçantë në metodën e gjuhësisë historiko-krahasuese. Hulumtimi mbështetet në dy shtylla kryesore empirike:
a) *Harta e institucioneve fetare e vitit 1924:* Burimi i parë përbëhet nga materiali kartografik i vitit 1924, i cili skicon shpërndarjen hapësinore të institucioneve të kultit në rajon. Ky dokument na lejon të kryejmë një analizë të gjeografisë gjuhësore, duke përcaktuar zonat e dendësisë së toponimeve sakrale ortodokse (shënuar me kryqe në hartë) dhe atyre myslimane apo teqeve (shënuar me simbole gjysmëhëne dhe katrorë të gjelbër). Shpërndarja e institucioneve fetare në vendbanimet e nënprefekturave të Kolonjës dhe Leskovikut, sipas hartës së vitit 1924:

1. **Nënprefektura e Kolonjës**
Kisha: Qafzez, Shtikë, Bezhan, Kalanj, Luaras, Blush, Vodicë, Selenicë, Radovickë, Kreshovë, Kurtës, Gostivisht, Lengës, Bejkovë, Novoselë, Mesiçkë, Ersekë, Rehovë, Borovë, Prodan, Barmash.
Xhami: Selenica e Pishës, Luaras, Selenicë, Novoselë, Starië, Kagjinas, Bënjëz, Kamnik, Leshnjë.
Teqe: Kalanj, Kreshovë, Starië, Ersekë, Gjonç, Barmash.

2. Nënprefektura e Leskovikut
Kisha: Kreshovë, Radimisht, Shalës, Kovaçisht, Delvinë, Pështan, Podë, Araz, Gërmenj, Zguraleç, Gjirokasë, Melan, Lashovë, Postenan, Radovë, Iljarë, Leskovik, Pobickë, Çerckë, Çarçovë, Seran.
Xhami: Shalës, Podë, Araz, Radanj, Vrepckë, Leskovik, Radat.
Teqe: Leskovik.

1. Kishat ortodokse (Ikona e Kryqit ✝)
Zona e Kolonjës ka një numër jashtëzakonisht të madh kishash të periudhës pasbizantine. Për shembull: *Në Rehovë*: Fshati shfaqet me shumë kryqe. Kjo përputhet me kishat e saj të famshme me gurë, si Kisha e Shën Kollit (Nikollës) dhe Kisha e Shën Thanasit. *Në Vodicë:* Kisha e Shën Mitrit, e njohur për afresket e vjetra. *Në Ersekë (Qendër):* Kishat kryesore urbane të zonës, si Kisha e Shën Gjergjit.
Mbi Postenan janë vizatuar dy kryqe. Postenani njihet historikisht si një fshat i madh me traditë të hershme e të pasur ortodokse, me kisha të ndërtuara me gurë dhe mjeshtëri të lartë kolonjare. Kisha kryesore dhe më e rëndësishmja e fshatit është Kisha e Shën Kollit (Nikollës), e cila ka qenë qendra e jetës shpirtërore të komunitetit. Gjithashtu, zona ka pasur kisha të tjera më të vogla apo kopshte kishash si ajo e Shën Mërisë apo e Shën Thanasit, të cilat shpjegojnë praninë e dy simboleve të kultit në hartë. Ndryshe nga Leskoviku apo Pobicka (që kanë simbole të zeza të minareve ose jeshile të teqeve), Postenani në vitin 1924 shfaqet ekskluzivisht me simbole të krishtera, çka tregon se popullsia e tij lokale në atë kohë ishte tërësisht e besimit ortodoks.
Vetëm në fshatin Shtikë kemi 13 hagiotoponime e eklezionime:
1.Shën Maria 2. Shën Kolli, 3. Shën Mërtiri, 4. Shën Gjergji, 5. Shën Sotiri, 6. Shën Premtja, 7. Manastiri i Hasit, 8. Bogovicë (vendi i perëndive), 9. Kryqi, 10.Qafa e Kryqi,t 11. Shën Kristofori, 12. Sheshet e Kryqit 13. Sheshi i Shën Gjergjit.

2. Teqetë dhe tyrbet kryesore (Ikona jeshile ■)
Në Leskovik (Qytet): Shfaqet një ikonë e madhe jeshile. Aty ndodhej Teqeja e Leskovikut (e njohur historikisht për ndikimin e Baba Alushit).
Në Barmash: Teqeja e Barmashit, një vatër e njohur patriotike dhe fetare e Bektashizmit.
Në Qesarakë : Teqeja e Qesarakës, e themeluar që në kohën e Ali Pashë Tepelenës nga Baba Ali Qesaraka.

3. Xhamitë (Ikona e minares/shigjetës ↑)
Në Leskovik dhe fshatrat përreth (si Radat, Pobickë): Harta tregon simbole të xhamive. *Leskoviku historik* kishte xhaminë e qytetit (Xhamia e Leskovikut), e cila shërbeu si qendër kryesore islame për zonën përpara shkatërrimeve të luftërave.
Në fshatrat e Kolonjës së Sipërme: Xhamitë lokale janë të ndërtuara kryesisht gjatë periudhës osmane për komunitetin mysliman të zonës.
b) *Regjistri kishtar i vitit 1946:* Burimi i dytë, i cili përbën bazën etimologjike dhe kronologjike të punimit, është dokumenti i datës 18 dhjetor 1946. Ky dokument përmban një listë të hollësishme të kishave të rrethit, ku krahas emrit të kishës (hagiotonimit zyrtar ose popullor),

shënohet me saktësi viti i ndërtimit apo i dokumentimit të parë të objektit. Dokumenti ka vlerë të veçantë për studimin historiko-gjuhësor të Kolonjës, sepse përmban tri kategori të rëndësishme të të dhënave:
1. Të dhëna toponimike: emrat e vendbanimeve ku ndodhen objektet e kultit.
2. Të dhëna kulturore dhe fetare: emërtimet e kishave sipas shenjtorëve, si Shën Kolli, Shën Gjergji, Shën Mëria, Shën Ilia, Shën Thanasi etj.
3. Të dhëna kronologjike: vitet e ndërtimit të objekteve, të cilat ndihmojnë në përcaktimin e shtresëzimit historik të trashëgimisë fetare në krahinë. Për shembull, ky regjistër dokumenton se kisha e Shën Ilisë në Prodan daton që nga viti 1646, ajo e Fjetjes së Shën Mërisë në Barmash nga viti 1676, ndërsa Shën Gjergji në Rehovë nga viti 1700.
Në krye të dokumentit përmendet emri i Theodhorit (leximi i emrit nuk është plotësisht i sigurt), i paraqitur si drejtor i një institucioni të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Dokumenti mban shënimin: Tiranë. Në pjesën hyrëse flitet për një çështje që lidhet me kishat dhe për nevojën e evidentimit të tyre, duke përmendur edhe një vendim ose shkresë të datës 20.XI.1944. Disa pjesë të këtij paragrafi janë të dëmtuara dhe nuk mund të transkriptohen me siguri. Shënimet përmbyllëse: Në fund të dokumentit dallohen: *Një shënim* me datën 18.12. 1946; *Formula përmbyllëse*: "Me bekime"; *Nënshkrimi i personit* që e ka hartuar ose vërtetuar dokumentin, ku dallohet titulli fetar, por emri nuk lexohet plotësisht.

Tabela: Kishat ortodokse sipas vendbanimeve dhe viteve të ndërtimit

Nr.	Fshati	Emërtimi i kishës	Viti i ndërtimit
1	Qafëzez	Shën Kolli	1930
2	Rehovë	Shën Kolli dhe Shën Anargjendët	1820
3	Rehovë	Shën Gjergji	1700
4	Blush	Shën e Premtja	1796
5	Blush	Shën Kolli	1840
6	Blush	Shën Mëria	1800
7	Barmash	Shën Mëria	1646
8	Barmash	Shën Kolli	1760
9	Barmash	Shën Gjergji	1720
10	Bejkovë	Shën Pjetri	1680
11	Bejkovë	Fjetja e Shën Mërisë	1912
12	Kreshovë	Shën e Premtja	1835
13	Gostivisht	Fjetja e Shën Mërisë	1856
14	Gostivisht	Shën Thanasi	1909
15	Ersekë	Shën Gjergji	1903
16	Shalës	Shën Kolli	1855
17	Shalës	Shën Mëhilli	1700
18	Lengëzë	Shën Mëria	1885
19	Vodicë	Shën Kolli	1877
20	Vodicë	Shën Mëria	1829
21	Borovë	Shën [i paqartë]	1970
22	Borovë	Shën Kolli	1900
23	Borovë	Shën Thanasi	1720
24	Prodanit	Shën Ilia	1646

25	Skorovot	Shën Mitri	1845
26	Skorovot	Shën Ilia	1800
27	Shtikë	Shën Sotiri	1806

Nga pikëpamja onomastike, këto data nuk shënojnë vetëm moshën e mureve të një objekti kulti, por shërbejnë si një *"terminus ante quem"* për formësimin dhe fiksimin e toponimit përkatës në gojën e popullit. Kur një kishë ekziston që nga viti 1646 në Prodan, kjo nënkupton se emri i Shën Ilisë ka qenë aktiv si pikë orientimi dhe toponim për më shumë se tri shekuj e gjysmë, duke pësuar gjatë kësaj kohe të gjitha ndryshimet fonetike karakteristike të gjuhës shqipe të asaj zone.

Edhe në periudhën e komunizmit, kur u ndalua feja dhe leksiku fetar, në këto zona emërtimet urbanistike hapësinore nuk mundën të ndryshoheshin te banorët e këtyre zonave. Pra urbanistika historike ka mbetur e njëjtë, edhe kur kufizimet politike u bënë të detyrueshme për shoqërinë tonë (Elsie, 2000). Emërtimet fetare duhen trajtuar si një shtresë e veçantë e onomastikës shqiptare, ku ndërthuren historia e gjuhës, tradita kishtare, kontakti gjuhësor dhe përdorimi popullor (Hough, 2016).

Nr.	Forma në zonën e Kolonjës	Forma prej gjuhës së ardhur	Dukuria gjuhësore
1	Shën Gjergji	greq. *Agios Georgios*	Përshtatje në sistemin shqiptar + përkthim i *agios → shën*
2	Shën Maria / Shën Mëria	greq. *Agia Maria*	Bashkëjetesë e formës më të kultivuar Maria me trajtën popullore Mëria
3	Shën Kolli	Nikolaos / Nikolla	Shkurtim dhe përshtatje popullore e emrit
4	Shën Mëhill	Mihail / Michael	Përshtatje fonetike dhe trajtë popullore shqiptare
5	Shën Mitri	Dhimitrios / Dimitër	Reduktim fonetik dhe formim i trajtës popullore Mitri
6	Shën Thanasi	Athanasios	Përshtatje fonetike: Athanasios → Thanasi
7	Shëndëlli / Shën Ilia	Elias / Ilia	Dy trajta shqiptare të emërtimit të të njëjtit shenjtor

3. Analiza fonetike historike e hagiotoponimeve

Analiza e lëndës toponimike të nxjerrë nga burimet e mësipërme zbulon disa dukuri të rëndësishme fonetike që dëshmojnë ndikimin e fuqishëm të sistemit të brendshëm të shqipes mbi emrat e huazuar të shenjtorëve (kryesisht nga greqishtja bizantine).

3.1. Fenomeni i sinkopës dhe apokopës (shkurtimi i emrave)

Në gojën e popullatës kolonjare, emrat e gjatë të shenjtorëve kanë pësuar një proces të rreptë rëniesh të rrokjeve të pataksuara, një pirje kjo mjaft e njohur në evolucionin e shqipes. Dokumenti i vitit 1946 na ofron shembuj të shkëlqyer:

Rasti i Shën Kollit: Forma zyrtare “Hagios Nikolaos"”ose “Shën Nikolla” shfaqet në dokument si “Sh. Kolli” (p.sh. në fshatrat Qafzez, Rehovë, Blush, Shalës, Vodicë). Këtu vërejmë rënien e rrokjes së parë **Ni-** dhe reduktimin e emrit në rrënjën **Koll**, duke i shtuar prapashtesën e shqipes. Kjo tregon një popullarizim të plotë gjuhësor.
Rasti i Shën Premtes: Për kishën e Kreshovës dhe Blushit dëshmohet forma Sh. Premtja (përkatësisht vitet 1835 dhe 1796). Emri grek *Paraskevi* është zëvendësuar tërësisht përmes kalkut kalkulues me fjalën shqipe ***e premte,*** duke u përshtatur në sistemin emëror të shqipes me nyjen e përparme dhe mbaresën shquese të gjinisë femërore.
Fshati Shëmtir i Kolonjës, nga hagiografia te mikrotoponimia, identiteti, kisha dhe kultura emërtuese
Kjo analizë trajton fshatin Shëmtir (historikisht Shën Mërtir) në rajonin e Kolonjës, duke zbërthyer shtresat e historisë, besimit, toponimisë lokale dhe transformimeve sociale që kanë formësuar identitetin e këtij vendbanimi. Identiteti i banorëve të Shëmtirit është formësuar nga pozita gjeografike e Kolonjës si krahinë e lidhur ngushtë me udhëkryqet tregtare, kurbetin dhe lëvizjet demografike.
Shëmtir është trajta popullore dhe e shkurtuar e emrit origjinal Shën Mërtir, e krijuar përmes rënies së zanoreve dhe bashkimit të rrokjeve gjatë përdorimit të përditshëm. Ky proces është mjaft i zakonshëm në toponiminë shqiptare, veçanërisht për emrat e vendeve që rrjedhin nga toponime fetare (agjonime). Prania e emrit Shën Mërtir tregon se fshati nuk u ndërtua thjesht si një njësi administrative apo bujqësore, por mori trajtë hapësinore rreth një qendre kulti, e cila i dha emrin të gjithë trevës përreth. Në strukturën tradicionale të fshatrave të Kolonjës, kisha nuk shërbente vetëm si objekt kulti, por si pikëtakim kryesor socio-kultural. Kisha e fshatit (dhe rrënojat ose qendrat e vjetra kishtare në afërsi) ka funksionuar si bërthama prej nga ku janë zhvilluar lagjet kryesore. Ajo shërbeu si hapësirë ku kryeheshin ritet e ciklit të jetës (pagëzimet, kurorëzimet, funeralet).
Emri fillestar Shën Mërtir përbëhet nga fjala Shën (Shënjt) dhe Mërtir (Martir/Dëshmor i fesë). Gjatë shqiptimit të shpejtë në të folmen e zakonshme, togfjalëshi ka humbur zanoren me theks të dobët dhe ka bashkuar tingujt bashkëtingëllorë (Shën Mërtir\Shën-mërtir\Shëmtir). Kjo lloj ngjeshjeje gjuhësore vihet re edhe në toponime të tjera në Shqipëri, si Shën Koll\Shënkoll, ose Shën Pjetër/Shënpjetër/Samapetrit.
Toponimi Shëmtir përbën një shembull tipik të asimilimit fonetik dhe evolucionit të agjonimeve (emërtimeve vendore me bazë kultin e shenjtorëve) në gjuhën shqipe. Emri origjinal Shën Mërtir lidhet drejtpërdrejt me kultin e dëshmorëve të krishterë (martirëve). Në traditën kishtare lindore dhe perëndimore, terma të tillë u viheshin vendeve ku ekzistonte një kishë me relike martirësh ose një vend ku përkujtohej një sakrificë e tillë.
Asimilimi i emrit nga Shën Mërtir në Shëmtir dëshmon se si kujtesa fetare mesjetare u shndërrua gradualisht në një identitet gjeografik e civil laik, ku emri i shenjtorit nuk përdorej më për ritual fetar, por si tregues i përkatësisë dhe origjinës së banorëve të kësaj toke.
Përmes ekonomisë së gjuhës në të folmen e përditshme, ka ndodhur procesi i tkurrjes fonetike dhe togfjalëshi ka kaluar në disa faza:
Gjatë këtij tranzicioni, tingulli bashkëtingëllor /n/ përpara /m/ është asimiluar në /m/, ndërsa zanorja e patheksuar është reduktuar plotësisht.
Paniqiret dhe panairet si festa të rëndësishme të kishës së Shën Mërtirit shërbenin si momente kyçe për bashkimin e komunitetit. Në këto ditë, hapësira e kishës shndërrohej në pikëtakim për tregti, lidhje krushqish, zgjidhje mosmarrëveshjesh dhe konsolidim të aleancave mes familjeve të Kolonjës.
Rreth kishës ose qendrave të vjetra të kultit shpesh grupoheshin mikrotoponime të tjera (si Lëndina e Kishës, Burimi i Shën Mërtirit, Ura e Kishës), të cilat krijonin një hartë të mbrojtur shpirtërore për vendasit.

Toponimia e zonës së Shëmtirit ndahet në disa kategori kryesore, secila prej të cilave dëshmon për mënyrën se si komuniteti e ka përdorur dhe emërtuar mjedisin e vet: *Toponime me bazë fetare* (hagionime): Shëmtiri, ku përfshihen edhe mikroemërtime si Kisha e Vjetër, Ara e Shën Mërtirit, apo Kroi i Shenjtë.
Toponime deskriptive (gjeografike): Emërtime që përshkruajnë relievin apo natyrën e zonës (p.sh. Guri i Kuq, Qafa e Frashërit, Gropat, Uji i Ftohtë).
Toponime antroponimike (nga emrat e njerëzve): Pronat, arat, burimet ose pjesët e malit që mbanin emrin e pronarit apo themeluesit të familjes (p.sh. Arat e Koleks, Mulliri i Llanit, Oraj e Shehut).
Sistemi i emrave të njerëzve (antroponimia) në zonën e Shëmtirit reflekton qartë periudhat historike nëpër të cilat ka kaluar kjo trevë. Tradita e vjetër e antoponimeve në zonën e Shëmtirit (krahinore-kristiane) nis me periudhën përpara shekullit XX, kur emrat ndiqnin traditën ortodokse lokale ose trajtat e shkurtuara popullore shqipe. Përdoreshin shpesh emra meshkujsh: Spiro, Jani, Dhimitër, Thanas, Petro, Kostandim (të shkurtuar shpesh në Koli, Tasi, Miti, Koçi). Emra femrash: Maria, Vasilika, Elena, Kostandina, Gjergjina (të shkurtuara në Marigo, Vaso, Leno).
Ndikimi i periudhës osmane dhe simbioza e ndryshimeve onomastike : Me ndryshimet e besimit në disa familje ose me hyrjen e administratës osmane, lindën edhe emra të traditës islame/bektashiane, shpesh të përshtatur në formën kolonjare si: Rexhep, Selim, Brahim, Ismail, Melek, Zyhra.
Periudha e laicizimit dhe emrat shqiptarë (gjysma e dytë e shekullit XX)

Pas mesit të shekullit XX, ashtu si në të gjithë Shqipërinë, pati një kthim drejt emrave me origjinë ilire, natyrore ose me kuptim patriotik si: Agron, Sokol, Ilir, Bardhyl, Dritan, Arben, Entela, Teuta, Mimoza, Pranvera.

Shëmtiri si pikëtakim social-kulturor

Fshati Shëmtir nuk funksiononte si një ishull i izoluar; ai shërbente si një pikëtakim i rëndësishëm në rrjetin e vendbanimeve të Kolonjës (pranë Ersekës dhe fshatrave përreth si Borova, Barmashi apo Taçi). Ky vend u bë urë lidhëse mes traditës dhe arsimimit. Shëmtiri dhe zona përreth tij u prekën zgodhshëm nga lëvizjet e Rilindjes Kombëtare. Emrat e njerëzve dhe vetëdija e komunitetit reflektuan mbështetjen për arsimin shqip dhe hapjen e shkollave.
Teqeja e Kreshovës përbën rast me interes për studimin e onomastikës fetare në hapësirën juglindore shqiptare. Të dhënat historike të lidhura me këtë qendër nuk kanë vetëm vlerë dokumentuese për historinë e bektashizmit, por ofrojnë një material të pasur gjuhësor, veçanërisht për toponiminë, antroponiminë, emërtimet e institucioneve dhe objekteve të kultit, si dhe për strukturën morfosintaksore të sintagmave emërtuese fetare (Kryegjyshata Botërore Bektashiane n.d. 2024).
Antroponimia e Teqesë së Kreshovës
Materiali i Teqesë së Kreshovës është i kufizuar, por ofron një tjetër grup të rëndësishëm emërtimesh: Hasan Babai, Xhemal Babai, Baba Selim Kreshova, Baba Muharrem Alushi, Dervish Zeqir Agalliu, Dervish Feim Mahmutaj. Këta emra janë me interes sepse shfaqin disa modele të ndryshme të strukturimit antroponimik.
Modeli I: emër + titull fetar: *Hasan Babai, Xhemal Babai*
Në këtë rast, Hasan dhe Xhemal janë emra personalë, ndërsa Babai funksionon si përcaktues i statusit fetar.
Modeli II: Titull fetar + emër + përcaktues: *Baba Selim Kreshova, Baba Muharrem Alushi, Baba Abdulla Myslim Çela*

Modeli III: Këtu struktura është: Titull fetar + emër personal + mbiemër/përcaktues antroponimik. Rasti *Baba Selim Kreshova* është veçanërisht i rëndësishëm për këtë studim onomastik fetar.

Ky model është më afër strukturës së antroponimisë moderne shqiptare, por ruan përpara saj elementin e statusit fetar.

Kreshova si toponim dhe si antroponim

Kreshovë → Kreshova, ku emri i vendit shfaqet si pjesë e emërtimit të një figure. Nëse Kreshova është përdorur si përcaktues prejardhjeje, atëherë kemi një tjetër rast të kalimit: *toponim → antroponim/përcaktues antroponimik.*

Nga analiza rezultojnë disa modele kryesore:

1. Objekt fetar + toponim: Teqeja e Kreshovës;
2. Objekt fetar + antroponim: Tyrbja e Baba Abdullahut; Tyrbja e Hysen Dedes.
3. Titull fetar + emër personal: Baba Abdullahu; Baba Hyseni; Dervish Qazimi.
4. Titull fetar + emër + përcaktues: Baba Selim Kreshova;
5. Toponim → përcaktues antroponimik: Kreshovë → Kreshova;

Këto modele tregojnë se emërtimi fetar në hapësirën e Kolonjës funksionon si një sistem i ndërthurur gjuhësor dhe kulturor, në të cilin emri i vendit, emri i personit, statusi fetar dhe hapësira e shenjtë ndërtojnë së bashku identitetin e objektit të kultit. Për këtë arsye, Teqeja e Kreshovës nuk duheT trajtuar vetëm si institucione me histori fetare, por si hapësira onomastike, ku emrat ruajnë gjurmë të marrëdhënieve midis vendit, individit, besimit dhe kujtesës kulturore (R. Elisie 2020, f. 283).

3.2. Evolucioni i bashkëtingëlloreve dhe rotacizmi popullor

Në regjistrin e vitit 1946, për fshatin Rehovë gjejmë të shënuar kishën e Sh. Jergjit (viti 1700). Ky shënim është mjaft i rëndësishëm për gjuhësinë historike:

Kalimi i bashkëtingëllores qiellzore të zëshme **/gj/** në një fërkimore shurdhët ose gjysmë-qiellzore **/j/** *(Gjergj -Jergj)* është një dukuri dialektore popullore e toskërishtes jugore. Fakti që vetë kleriku e ka shënuar këtë formë në një dokument zyrtar tregon se trajta *Jergj* kishte fituar qytetari të plotë gjuhësore dhe kishte zëvendësuar formën e normuar kishtare.

Po ashtu, forma Sh. Mitri në Skorovot (1485 ose 1845 sipas shënimit të dokumentit) tregon rënien e pjesës fundore **-os** të greqishtes (Demetrios) dhe përshtatjen e grupit të bashkëtingëlloreve **/tr/** sipas natyrës së shqipes, duke u kthyer në një emër mashkullor të lakueshëm të tipit me temë në bashkëtingëllore.

4. Toponimet si dëshmitare të kronologjisë së banimit

Një nga debatet më të rëndësishme në historiografinë dhe gjuhësinë ballkanike është ajo e vazhdimësisë së banimit të popullatës shqiptare në trojet e tyre. Hagiotoponimet e Kolonjës dhe Leskovikut ofrojnë argumente të pathyeshme në favor të kësaj autoktonie.

Në dokumentin e vitit 1946, kisha e Prodanit shënohet si Sh. Ilia (viti 1646). Emri i fshatit Prodan, ka një etimologji që ka qenë objekt diskutimi, por bashkëngjitja e toponimit sakral Shën Ilia prej më shumë se tre shekujsh dëshmon se popullata shqipfolëse e ka përdorur këtë vend kulti në mënyrë të pandërprerë. Po ashtu, prania e toponimeve si Sh. Mëri në Barmash (1676) dhe Lëngëzës (1885) tregon se emërtimet sakrale kanë mbetur të rrënjosura në kujtesën e fshatit, madje edhe kur strukturat demografike apo fetare kanë pësuar ndryshime përgjatë periudhës osmane.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të shpërndarjes dhe vjetërsisë së këtyre monumenteve gjuhësore, tabela e mëposhtme përmbledh disa nga të dhënat kyçe të nxjerra direkt nga dokumenti arkivor i vitit 1946:

Lokacioni (Fshati)	Forma e Dokumentuar (1946)	Viti i Dokumentimit	Dukuria Gjuhësore / Shënime
Prodani	Sh. Ilia	1646	Ruajtja e trajtës popullore arkaike të emrit Elias.
Barmashi	Fjetja e Sh. Mërisë	1676	Përkthim kalk i konceptit bizantin "Koimesis".
Rehova	Sh. Jergji	1700	Zbutja fonetike dialectore /gj/ -> /j/ (Toskërisht).
Blushi	Sh. Premtja	1796	Leksikalizim i plotë përmes ditës së javës në shqip.
Skorovoti	Sh. Mitri	1845	Sinkopë dhe apokopë e trajtave të greqishtes.

5. Përfundime

Në mbyllje të këtij studimi mbi hagiotoponimet e trevës së Kolonjës dhe Leskovikut, mund të nxjerrim disa përfundime me rëndësi shkencore:
1. Hagiotoponimet e kësaj zone nuk janë thjesht emërtime fetare, por monumente të vërteta gjuhësore që reflektojnë identitetin fonetik dhe morfologjik të dialektit toskë të shqipes. Format si "Sh. Jergji" apo "Sh. Kolli" vërtetojnë asimilimin e plotë të elementit të huaj brenda strukturës amtare, duke realizuar *integrim gjuhësor:*
2. Dokumentet e viteve 1924 dhe 1946 ofrojnë një bazë të shkallëzuar kronologjike që lejon gjurmimin e toponimisë deri në mesin e shekullit XVII, duke shërbyer si një dëshmi e fortë për *qëndrueshmërinë historike* të popullatës vendase.
3. Bashkekzistenca e institucioneve të krishtera dhe atyre myslimane në hartën e vitit 1924 pasqyrohet edhe në toponimi, ku shpesh pikat sakrale mbivendosen apo bashkëjetojnë në një hapësirë të ngushtë gjeografike, duke dëshmuar një simbiozë të rrallë kulturore, pra *një gjeografi kulturore.*

References

[1]. Arkivi i Muzeut Historik të Ersekës, Harta e Institucioneve Fetare dhe Arsimore e Nënprefekturës së Kolonjës, 1924.
[2]. Dokument Arkivor i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Raporti i Atë Stavro At. Naumit, datë 18 Dhjetor 1946.
[3]. Çabej, E. 1976. "Studime etimologjike në fushë të shqipes", shqipes (Vëll. 1). Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
[4]. Demiraj, Sh. 1986. "Gramatikë historike e gjuhës shqipe". Shtëpia Botuese "8 Nëntori".
[5]. Riza, Selman. 1965. "Studime mbi Toponiminë Shqiptare", Prishtinë
[6]. Shkurtaj, Gjovalin. 2003. "Onomastika dhe Etnografia Gjuhësore e Trojeve Shqiptare", Tiranë.
[7]. Riska, A. 2012. Shqipja dhe krishtërimi. Dituria.

[8]. Riska, A. 2013. The Christian Saints in the (Micro)toponymy of Albania. Anglisticum Journal (IJLLIS).
[9]. Shkurtaj, Gj. 2001. Onomastikë dhe etnolinguistikë. Tiranë: SHBLU. Shkurtaj, Gj. (2015). Onomastikë dhe etnolinguistikë. Albas.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

3(062.552)
1(062.552)

INTERNATIONAL congress „From research to application" (2026 ; Tetova)
Proceedings book / International congress „From research to application", 18-19 November, 2026 Tetova, Republic of North Macedonia ; [editor Kushtrim Ahmeti]. - Tetovë : Universiteti i Tetovës, 2026. - 1507 стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-217-161-6

а) Општествени науки -- Собири б) Хуманистички науки -- Собири

COBISS.MK-ID 70160133